



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Nr prot: 516

Tiranë, 15/07/2019

MIRATOHET

Kryetari

Bujar LESKAJ

PLANI I MASAVE AFATSHKURTRA

“ MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PËR KLSH,

ADRESUAR NË RAPORTIN E KOMISIONIT EVROPIAN PËR SHQIPËRINË PËR VITIN 2019”

Komisioni Evropian ka publikuar në datën 29 maj 2019 Progres Raportin për vitin 2019, në të cilën vlerësohet ecuria dhe progresi për plotësimin e kritereve të vendosura nga BE në kuadrin e integritetit të Shqipërisë në familjen e Bashkimit Evropian. Si një nga tre elementët e **Kapitulli 32 “Kontrolli financiar”** të *Acquis Communautaire*, në Progres Raport janë cituar niveli i arritjes dhe përmbushja e kërkesave të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe janë përcaktuar rekomandimet përkatëse.

Auditimi i jashtëm

1. “*Kuadri kushtetues dhe ligjor i Shqipërisë parashikon pavarësinë e Institucionit Shtetëror të Auditimit (SAI) në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Megjithatë, ende duhet të sigurohet zbatimi i plotë i kuadrit ligjor.*”¹

2. *Sasia e madhe e raporteve vjetore të auditimit të prodhuara nga SAI ndikon në kapacitetin e saj institucional. Në vitet e fundit, ALSAI ka ndërmarrë masa për të përmirësuar zhvillimin profesional të stafit të tij të auditimit.*

3. *ALSAI po zbaton Strategjinë e Zhvillimit 2018- 2022 dhe Strategjinë e Komunikimit 2017-2019. Cilësia e punës audituese duhet të përmirësohet më tej, pasi aktivitetet e auditimit ende nuk i përmbushin plotësisht standardet e INTOSAI-t.*²

4. *Në vitin 2018, KLSH dha për herë të parë një opinion mbi ekzekutimin e buxhetit të shtetit për vitin 2017. Në qershor të vitit 2018, ALSAI miratoi një qasje të auditimit të jashtëm të bazuar në rrezik. Numri i auditimeve të performancës u rrit në 18 në 2018, në krahasim me 15 në vitin 2017. Ndikimi i auditimit është i kufizuar dhe zbatimi në kohë i rekomandimeve të auditimit duhet të përmirësohet*”³.

5. *Raportet e auditimit janë përmbledhur në baza tremujore dhe publikohen rregullisht në faqen e internetit të SAI-t.*

6. *Memorandumi i Mirëkuptimit i 2017 ndërmjet ALSAI-t dhe Ministrisë së Financave për monitorimin e rekomandimeve të auditimit ka rezultuar me krijimin e një sekretariati teknik me përfaqësuesit e të dyja palëve.*⁴

Në referencë të çështjeve të sjella në vëmendje nga vlerësimet e bëra në këtë Progres Raport, si një vazhdimësi në linjë me objektivat e vendosura në Strategjinë e Zhvillimit të KLSH-së 2018 – 2022⁵ dhe në Strategjinë e Komunikimit të KLSH-së 2017-2019⁶ për të siguruar përmbushje të plotë të kërkesave në fushën e auditimit të jashtëm në sektorin publik në Shqipëri, KLSH është e angazhuar të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme të cilat adresojnë në mënyrë efektive zbatimin e të gjitha rekomandimeve në kohë, me cilësi dhe raportimin e tyre.

¹ Faqe 98, paragrafi i parafundit, <https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>.

² Faqe 98, paragrafi i fundit, faqe 99, paragrafi i parë.

³ Faqe 99, paragrafi i dytë

⁴ Faqe 99, paragrafi i tretë

⁵ “Strategjia Zhvillimit të KLSH 2018 – 2022” miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr.228, nr. 1353 prot, datë 31.12.2017 http://www.klsh.org.al/web/strategjia_zhvillimit_klsh_2018_2022_2_opt_4004.pdf

⁶ Strategjia e Komunikimit të KLSH-së 2017-2019, miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH nr. 16/48 prot, datë 31.07.2017.

Nr.	Masa/aktivitete	Palët e përfshira	Afati	Treguesi i rezultatit	Treguesi i impaktit
Rekomandimi nr. 1 Të sigurohet zbatimi i plotë i kuadrit ligjor të KLSH					
1.	Propozim për amendime në Ligjin nr. 154/2014 “Për funksionimin dhe organizimin e KLSH-së”.	KLSH – Kuvendi i Shqipërisë	Nga 2018	Miratimi i propozimeve për ndryshime në Ligjin 154/2014	Sigurimi i zbatimit të kuadrit ligjor për KLSH <i>de juro dhe de facto</i> . KLSH të ushtrojë veprimtarinë në përputhje me kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare të profesionit.
Rekomandim nr. 2 : Cilësia e punës audituese duhet të përmirësohet më tej					
2.1	Zhvillimi dhe përditësimi i kuadrit metodologjik dhe udhëzues të auditimit në përputhje të plotë dhe duke pasqyruar kërkesat e Standardeve të INTOSAI-t (ISSAI, GAO-s dhe praktikave më të mira të auditimit të Institucioneve Ndërkombëtare të Auditimit dhe të vendeve anëtare të BE-së).	KLSH	Në vijimësi	Kuatër metodologjik i ndryshuar dhe i përditësuar në kohë dhe në linjë me kërkesat e standardeve	Profilizimi i KLSH-së si një institucion modern evropian i auditimit suprem publik, i cili e bazon aktivitetin e tij tërësisht në standardet ndërkombëtare ISSAI të INTOSAI-t.
2.2	Vendosja dhe aplikimi i një sistemi efektiv për menaxhimin e cilësisë së auditimit, i cili siguron përdorimin e suksesshëm të dy elementëve për Kontrollin dhe Sigurimin e Cilësisë në planifikimin, kryerjen, raportimin dhe mbikëqyrjen e punës audituese.	KLSH	Brenda vitit 2019 dhe në vijim	Udhëzues për Menaxhimin e Cilësisë në KLSH i miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH. Raportim për monitorimin e kontrollit dhe sigurimit të cilësisë	
2.3	Zhvillimi dhe aplikimi i një qasje bashkëkohore në auditimin e ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit mbështetur në kërkesat e ISA 600 dhe ISSAI 1600 “ Kërkesa të veçanta për auditimin e Pasqyrave Financiare të grupit, përfshirë	SIGMA KLSH	Brenda vitit 2019 dhe në vijim	Udhëzues për “ Auditimin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit” i miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH	Formëzimi dhe formatizimi i procesit të auditimit të zbatimit të buxhetit të shtetit në standardet dhe cilësinë më të lartë të punës audituese duke siguruar që KLSH të përmbushë me sukses të Objektivit

	punën e auditimeve të njësjive shpenzuese” ⁷				kryesor të këtij auditimi për dhënien e opinionit për Raportin që Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Këshilli i Ministrave paraqet në Kuvend “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2017” duke audituar jo vetëm rregullaritetin e transaksioneve por edhe saktësinë e raportimeve që kanë të bëjnë me zbatimin e buxhetit, përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe fondeve të kontigjencës, raportimin e borxhit publik, funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe organizimin e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik
2.4.	Forcimi i kapaciteteve audituese në fushën e PPP –ve ⁸	SECO KLSH	2020- 2021	Trajnime për audituesit mbi kornizën ligjore të PPP-ve , kërkesat e legjislacionit evropian dhe praktika të tjera ndërkombëtare të kryera nga ekspertët lokalë dhe të huaj brenda dhe jashtë vendit. Hartimi udhëzuesve të posaçëm për të ndihmuar audituesit në auditimin e PPP-ve.	Rritja e numrit dhe cilësisë së auditimeve të KLSH në vlerësimin e implementimit të PPP-ve duke e konsideruar si një nga fushat me risk më të lartë për ekonominë shqiptare.
2.5.	Propozimi i një Projekti ⁹ për mbështetjen e KLSH në fusha specifike të zhvillimit të kapaciteteve institucionale dhe të auditimit të KLSH për t’u përfshirë në financimet e BE-së për Shqipërinë	Delegac. i BE-së KLSH	Tremujori i fundit 2019	Aplikimi dhe dakortësimi për të përfutur nga asistenca teknike e BE-së për Shqipërinë;	Zbatimi i plotë i rekomandimeve të Projektit IPA 2013 “Forcimi kapaciteteve të auditimit të jashtëm në sektorin publik në Shqipëri” ¹⁰ dhe sigurimi i qëndrueshmërisë së arritjeve të Projektit IPA dhe në vitet e ardhshme.

⁷ SIGMA – Mbështetje për KLSH i ka mundësuar KLSH asistencë në vazhdimësi për rritjen dhe forcimin e kapaciteteve audituese. Me kërkesë të Kryetarit të KLSH, SIGMA do të vijojë asistencën për audituesit nëpërmjet mbështetjes për zhvillimin e një Udhëzuesi Specifik për Auditimin e Zbatimit të Buxhetit përgjatë gjithë vitit 2019.

⁸ KLSH ka aplikuar për mbështetje nga SECO nën Projektin : Forcimi i Kapaciteteve në Auditimin e PPP –ve. Projekti është në fazë diskutimi.

⁹ KLSH do të përgatisë fishat e projektit duke adresuar rekomandimet e Progres Raportëve të KE-së dhe të SIGMA-s, dhe si një vazhdimësi e Projektit të Binjakëzimit.

¹⁰ Projekti i Binjakëzimit i implementuar nga SAI i Polonisë dhe i Kroacisë ofroi asistencë për KLSH-në në periudhën Mars 2016 –Korrik 2018 duke siguruar një hap të rëndësishëm në zhvillimin dhe reformimin e Institucionit të KLSH-së.

2.6	Trajnimi i audituesve me njohuri të reja dhe ruajtja e nivelit të lartë në ndjekjen e trajnimeve.	KLSH	Në vijimësi	Trajnime të kryera Auditues të trajnuar mesatarisht 25 ditë trajnimi në vit	Rritja e kapaciteteve audituese dhe e cilësisë së auditimit, e udhëhequr nga parimet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, duke e bazuar zhvillimin metodologjik dhe profesional të burimeve njerëzore në dy shtylla kryesore: krijimin e një profili të lartë profesional të audituesit të jashtëm publik; dhe sigurimin e kryerjes së veprimtarisë audituese në përputhje të plotë me standardet e auditimit të jashtëm publik si dhe praktikat e mira të fushës të konkretizuara në manualet e auditimit, rregullore të procedurave të auditimit, përmirësimin e raportimit dhe transparencës si dhe trajnimi e vazhdueshëm të stafit auditues.
2.7	<p>a) Publikimi i raporteve të auditimit në formë të përmbledhur në formatin “Open Data”, sipas instrumentit të zhvilluar me ndihmën e Projektit të USAID “Transparenca në Sistemin Shëndetësor”. Nëpërmjet këtij instrumenti, klasifikimi i raporteve të auditimit sipas fushave të ndryshme si Shëndetësi, Arsim, Financë, Qeverisje Lokale, etj.</p> <p>b) Përdorimi i “Data Mining”, sipas instrumentit të zhvilluar me ndihmën e Projektit, për nxjerrjen e të dhënave të ndryshme nga mediat online, si artikuj të përgatitur nga stafi i KLSH, apo që citojnë gjetje të auditimeve të KLSH-së.</p>	KLSH Qendra për Emancip. Ekonomik të Medias	Në vijimësi	Trajnime të kryera	<p>Në përmbledhjen në formatin “Open Data”, raporti i auditimit do të përmbajë informacion për ‘Kontekstin e Problemit Social’, ‘Subjektet nën Auditim’, ‘Objektivi i Auditimit’ dhe ‘Konkluzionet’. Krahas kësaj përmbledhjeje, bashkëngjitur do të vendoset raporti i plotë si dhe dokumente të tjera me të dhëna që janë përdorur në raport në formë tabelash apo grafikësh/imazhesh. në formë të aksesueshme nga publiku. Një publik më mirë i informuar dhe më i sensibilizuar ndaj punës së KLSH.</p> <p>Instrumenti “Data Mining” bazohet në fjalë kyçe në fokus të KLSH si efektivitet, eficiency, ekonomicitet, dëm ekonomik, auditim, të ardhura të munguara, përmirësime ligjore, abuzim, korrupsion, etj. dhe aksesohet për një afat të papërcaktuar, pavarësisht së çfarë zgjedhin</p>

	c) Instrumenti Red Flags , produkt i projektit me USAID-in. Ky instrument do të përdoret për vlerësimin dhe skanimin e procedurave të prokurimeve. Ky algoritëm analizon bazën e të dhënave ku vendosen procedurat e tenderimit dhe i klasifikon ato automatikisht në problematike ose jo.				të bëjnë mediat online me artikujt originalë. Një publik më mirë i informuar dhe më i sensibilizuar ndaj punës së KLSH. Instrumenti Red Flags , mundëson indicie në kohë reale mbi procedura me probabilitet për sjellje të papajtueshme me ligjin ose jo-etike të biznesit, kryesisht në lidhje me mos respektimin e ligjeve anti-korrupsion.
2.8	Realizimi i portalit “AuditiPublik.al”, në bashkëpunim me Qendrën për Emancipimin Ekonomik të Medias, një OJF në fushën e transparencës së administrimit publik, për rritjen e informacionit online për publikun, lidhur me gjetjet dhe rekomandimet kryesore të auditimeve të KLSH.	KLSH Qendra për Emancipim in Ekonomik të Medias	korrik 2019-qershor 2020	Tryeza pune për shkëmbim informacioni, trajnime.	Një publik më mirë i informuar dhe më i sensibilizuar ndaj gjetjeve dhe rekomandimeve të KLSH. Materialet e portalit-lëndë e parë për gazetatat, radiot dhe televizionet.
2.9	Realizimi i News Letter mujore për aktivitetin e KLSH-së brenda dhe jashtë vendit në bashkëpunim me Qendrën për Emancipimin Ekonomik të Medias.	KLSH Qendra për Emancipim in Ekonomik të Medias	Në vijimësi	Takime për shkëmbim informacioni	Rritja e transparencës së aktivitetit të KLSH-së, me qëllim informimin e qytetarëve, lidhur me mënyrën e shpenzimit të parasë publike.
2.10	Vijimësia e kolanës së botimeve të KLSH-së, prezenca e audituesve të KLSH-së me shkrime në shtypin e përditshëm dhe realizimi i muajit të hapur çdo vit.	KLSH	Në vijimësi; Muaji i hapur në nëntor 2019.	Numri i botimeve; Numri i shkrimeve të audituesve në media; Realizimi i muajit të hapur.	Botimet dhe realizimi i Muajit të hapur përçojnë në publik drejtimit strategjike të zhvillimit dhe reformimit të institucionit, duke ndikuar në përmirësimin e qeverisjes publike.
Rekomandimi 3: Zbatimi në kohë i rekomandimeve të auditimit duhet të përmirësohet. Shqipëria duhet të sigurojë zbatimin më sistematik dhe në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm.					

3.1	Dërgimi në Kuvend si pjesë e raportit vjetor të performancës edhe i raportit mbi ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit	KLSH-Kuvendi Shqipërisë	Prill 2019	Raporti Vjetor i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të auditimit dërguar nga KLSH tek Kuvendi i Shqipërisë	KLSH, në rolin e institucionit si agjent i Kuvendit për mirë-menaxhimin e parasë publike, udhëhiqet nga thellësia e argumentit dhe gjetjes audituese, dobia sa më e plotë e rekomandimeve, në përmirësim konkret të menaxhimit të fondeve publike, sipas orientimeve të standardeve ISSAI, duke siguruar drejtpërdrejtshmëri dhe lexueshmëri nga anëtarët e Kuvendit.
3.2	Dërgimi çdo katër muaj në Kuvend i Raportit të Konsoliduar të Zbatimit të Rekomandimeve	KLSH Kuvendi Shqipërisë	Korrik, Shtator 2019 Janar 2020	Raporte periodike mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të KLSH dërguar në Kuvendin e Shqipërisë	Nëpërmjet këtyre raporteve KLSH i bën me dije Kuvendit dhe Ekzekutivit zbatimin e rekomandimeve, duke pasqyruar të dhëna agregate por edhe të detajuara për të gjitha llojet e rekomandimeve si dhe në nivel institucional.
3.3	Kërkesa për krijimin të një nën komisioni të dedikuar për shqyrtimin e raporteve të auditimit/dhe nivelit të zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara konsideruar ky i fundit si një mekanizëm efektiv për rritjen e llogaridhënies nga institucionet qeveritare.	KLSH Kuvendi Shqipërisë	Në vijimësi	Krijimi i Nën Komisionit për çështje të auditimit në Kuvendin e Shqipërisë	KLSH në funksion të rritjes së nivelit të implementimit të rekomandimeve, do të vijoje të insistojë në përdorimin e të gjitha instrumenteve institucionale në drejtim të
3.4	Dërgimi tek (Ekzekutivi) Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin në mënyrë periodike të Raportit të zbatimit të rekomandimeve në funksion të ndjekjes së zbatimit të tyre nga subjektet e audituara.		Korrik 2019 Janar 2020	Raporte specifike në funksion të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi dërguar nga KLSH tek Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin	adresimit të kërkesave për institucionalizimin e një bashkëpunimi dhe partneriteti efektiv midis Parlamentit, KLSH-së dhe Qeverisë dhe rritjes së mbikëqyrjes parlamentare.
3.5	Zhvillimi i seancave dëgjimore parlamentare për të diskutuar rekomandimet e auditimeve me interes të veçantë.	KLSH Kuvendi Shqipërisë- Ministrinë/Institucionet e audituara	Në vijimësi	Rezolutat e Kuvendit të Shqipërisë	Mbështetur në praktikat më të mira dhe konkluzionet dhe rekomandimet e dala nga dokumente vlerësuese të SIGMA-s dhe Bankës Botërore/ PEFA-s, KLSH do të theksojë dhe më tej kërkesën për organizimin e dëgjësive publike dhe në

3.6	Dërgimi ne Komisionet respektive te raporteve te auditimit, te auditimit te performancës dhe Raporteve me rëndësi dhe ndjeshmëri te lartë publike.	KLSH - Kuvendi Shqipërisë	Në vijimësi	Raporte të Auditimit me interes ë lartë publik dërguar nga KLSH për Kuvendin e Shqipërisë	mënyrë të veçantë të Komisioneve përkatëse Parlamentare me njësitë e audituara, me qëllim ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe rritjen e impaktit të raporteve të KLSH. Ndërgjegjësimi i anëtarëve të Kuvendit për vlerën që i sjell shtetit dhe shoqërisë një auditim efektiv publik dhe rolin e ndërsjellë të legjislativit në rritjen e impaktit dhe shtimin e vlerës së auditimeve të KLSH duhet të qëndrojë në themel të përpjekjeve të KLSH për të siguruar një ambient të jashtëm mbështetës dhe të dobishëm
3.7	Përdorimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me Ministrinë e Financave dhe aktorë të tjerë për zhvillimin e instrumenteve të duhur me përfitim të përbashkët për zbatimin e rekomandimeve të auditimit publik (përfshirë auditimin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm).	KLSH - Institucionet e audituara	Në vijimësi	Takime të përbashkëta dhe tryeza diskutimi me njësitë publike të audituara lidhur me zbatimin e rekomandimeve	Rritja e ndërgjegjësimit mbi rolin e KLSH dhe vlerat e auditimit në njësitë e audituara
3.8	Në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është krijuar dhe funksionon Sekretariati për Bashkëpunim ndërmjet dy institucioneve, i cili një ndër objektivat ka të cilësuar krijimin e mekanizmave efektiv për të siguruar rritjen e niveli të zbatimit të rekomandimeve të auditimit.	KLSH - Ministria e Financave-Sekretariat i teknik i bashkëpunimit	Në vijimësi	Nr. Aktivitetesh të përbashkëta midis dy institucioneve; Nr. I aktiviteteve të Sekretariatit të Përbashkët	Forcimi I bashkëpunimit ndërmjet KLSH dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë , strukturave përkatëse të sistemit të KBFP (auditimit të brendshëm, menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe inspektimit financiar) me qëllim sinergjizimin e veprimtarive për rritjen e efektivitetit dhe forcimin e rolit të auditimit në sektorin publik në Shqipëri.
3.9	Kryerja e verifikimit te zbatimit te rekomandimeve të mëparshme ne çdo mision auditimi.	KLSH	Në vijimësi sipas Planit Vjetor të Auditimeve të KLSH	Ndjekja dhe monitorimi i treguesve të pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve : 1. Nr. Rekomandimeve të pranuar kundrejt rekomandimeve të dhëna; 2. Nr. Rekomandimeve të zbatuara kundrejt rekomandimeve të pranuar.	KLSH synon të rrisë influencën dhe impaktin e auditimeve të saj duke zgjeruar bazën e përdoruesve të produkteve të saj, gjetjeve, opinioneve dhe rekomandimeve të auditimeve, për t'i shërbyer qoftë përdoruesve direkt ashtu dhe indirekt, duke përdorur kanalet më efektive të komunikimit për të mbërritur

3.10	Kryerja e auditimeve tematike te veçanta për verifikimin e zbatimit te rekomandimeve me qellim evidentimin e nivelit te zbatimit te rekomandimeve dhe hartimin e raportit te konsoliduar te zbatimit te rekomandimeve.	KLSH	Në vijimësi sipas Planit Vjetor të Auditimeve të KLSH	<p>Ndjekja dhe monitorimi i treguesve të pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve :</p> <p>3. Nr. Rekomandimeve të pranuar kundrejt rekomandimeve të dhëna;</p> <p>4. Nr. Rekomandimeve të zbatuara kundrejt rekomandimeve të pranuar.</p>	<p>deri tek përdoruesi më i fundit, qytetari i thjeshtë.</p> <p>Identifikimi i perceptimit të veprimtarisë së KLSH-së nga qytetari dhe palët e tjera të interesit nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile të specializuar për të realizuar këto lloj matjesh, do të përbëjë instrumentin bazë të përmirësimit të vazhdueshëm të instrumenteve që do të rrisin impaktin dhe përdoruesit e produkteve të KLSH-së</p>
------	--	------	---	--	--